

**RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE TRASFORMOMIT
TE " TREG - AUTO " SHPK NE SHOQERI ANONIME**

SHOQERIA " TREG - AUTO " SHPK

Me kapital themeltar 100.000 Leke

Me seli ne Rr. " Kavajes " Tirane

Raport i Ekspertit Kontabel te Autorizuar

I parashikuar nga nenet 73 dhe 77

E Ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992

Violeta Mullai

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Anetare e I E K A Licenca nr. 38

Adresa Rr. " Budi " pall, 58/1

Tirane

Me Vendim te Gjykates Tirane Nr. 2244/1 dt 28.07.2003 i marre ne baze te kerkeses se administratorit tuaj ne kuadrin e projektit per transformimin e shoqerise tuaj **ne shoqeri anonime**, jam caktuar si ekspert ne misjonet e parashikuara nga neni 73 dhe 77 i Ligjit 7638 " Per Shoqerite Tregtare "

Une kam nderin tju raportoj per ekzekutimin e ketyre misjoneve te cilat konsistojne nga njera ane ne paraqitjen e nje raporti per gjendjen e shoqerise (neni 73) dhe, nga ana tjeter , ne vleresimin e vlerave te pasurive qe perbejne aktivin e shoqerise dhe avantazhet e vecanta qe mund te ekzistojne ne perfitim te ortakeve ose te te treteve (neni 77) dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten e barabarte me ate te kapitali themeltar.

Per kryerjen e ketyre misjoneve kam disponuar bilancin e shoqerise se hartuar per dt. 31.12.2002, date e mbylljes se ushtrimit te fundit , si dhe dy bilancet e viteve 2000 dhe 2001 , ushtrime paraardhese dhe te dokumenta te tjera te nevojshme per kontrollin e elementave te ketyre bilanceve.

Kontrolli im u krye teresisht ne zyrat e shoqerise " Treg - Auto " ku hartohen bilancet dhe dokumentat e tjere kontabel , ku na u dhane spjegimet plotesuese per elementet e bilanceve te plotesuara si dhe per evoluimin e situates se shoqerise qysh nga dt. e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit.

Perveç kesaj avokati juaj na dha informacionet e nevojshme per modalitet juridike te operacionit te transformimit te parashikuar.

Ne baze te hapave te ndermara te punes se kryer jam ne gjendje tju bej te njohur perfundimet qe vijojne ne kuadrin e raporteve te parashikuar nga ligji.



1. (Raport) Mbi gjendjen e shoqerise.

(Raport) i kerkuar nga neni 73 i ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

Nga shqyrtimi i tre balanceve te fundit del qe shoqeria ka realizuar gjithnje fitime gjate tre ushtrimeve financiare , dhe konkretisht :

Ushtrimi 2000..... 1.042.934 Leke
Ushtrimi 2001..... 1.539.408 Leke
Ushtrimi 2002.....129.091 Leke.

Duke patur parasysh caktimin per rezerva te rezultatit te ushtrimit te mbyllur me 31.12.2002 ne masen 10.000 leke , kaptalet e veta arrine me kete date 2.777.683 leke dhe perbehen si vijon :

* Kapitali themeltar	100.000 leke
* Rezerva ligjore	10.000 leke
* Fitime te ushtrimeve	<u>2.667.683 leke</u>
	2.777.683 leke

Si konkluzion llogarite vjetore qe kam shlyrtuar sipas mendimit tim , shprehin ne menyre korrekte situaten financiare dhe pasurore te shoqerise , e cmuar kjo ne kuadrin e vijimesise te veprimtarise.

M.q.se ne kuadrin juridik qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar per tu trasformuar ne nje shoqeri anonime duhet te plotesoje kufirin minimal ligjor te kapitalit themeltar ne vleren 2.000.000 leke , ju ve ne dijeni se ky kusht eshte plotesuar , dhe kjo gje konfirmohet nepermjet Veretimit te derdhjes se shumes prej 2.000.000 leke nga Gjergj Vocaj, hartuar te noterja Aferdita Haxhia me Nr. Rep 3596 dhe Nr. Kol 457 , dhe ne kete menyre kapitali themeltar i kesaj shoqerie behet 2.100.000 leke, duke bere te mundur realizimin e transformimit te Shoqerise " Treg Auto " Shpk ne Sh.a.

2. (Raport) Mbi vleren e pasurive qe perbejne aktivin e shoqerise dhe avaantazhet e vecanta.

(Raport) I kerkuar nga Neni 77 i ligjit 7638 date 19.11.1992

a.Vlera e pasurive qe perbejne aktivin e shoqerise .

Per shkak te natyres se vecante te misjonit tim i cili nuk konsiston aq sa per te vleresuar peshen (rendesine , materjalitetin) e plus vlerave eventuale te fshehta , se sa per tu siguruar qe vlerat kontabel qe rezultojne sipas bilancit nuk kane mbivleresim te pasurise te shoqerise.

Aktivi i shoqerise i pasqyruar ne bilanc perbehet nga elemente qe vijojne :

Aktive te qendrushme	zero
Aktive qarkulluse	<u>4.794.667 leke</u>
	4.794.667 leke

Ne kundra parti detyrimet :

<u>Te kerkushme pas 1 viti</u>	<u>2.016.984 leke</u>
	2.016.984 leke

Aktivi neto konbtabel rezulton :
 $4.794.667 - 2.016.984 = 2.777.683$



Vleresimi i cdo posti te aktivitet dhe pasivitet eshte bere nga ana ime objekt shqyrtimi i vemendeshem ne kushtet e paraqitura si me poshte :

AKTIVET E QENDRUESHME

- Elemente te trupezuara.

Nga verifikimi i bilancit dhe i gjendjes fizike rezultojne te jene zero.

- Aktive financiare.

Perbehen nga garanci te kontabilizuara per vleren e tyre nominale prej 2.000.000 leke.

AKTIVI QARKULLUES DHE PASIVI I KERKUESHEM.

Aktivet qarkulluese jane te vleresuar drejt , me koston e blerjes se tyre , dhe nuk ka vrejte nga ana ime .

Verifikimi i posteve te pasiveve te kerkueshme nuk ka nxjere asgje jo normale duke patur parasysh qe deri ne daten e nderhyrjes tone nuk morem dijeni per ndonje konflikt te mundeshem ose rezik per te ndryshuar situaten e shoqerise.

PERFUNDIM :

Ne te verifikimeve te bera dhe duke patur parasysh hollesite e dhena me siper qe vlera neto kontabel e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise , ashtu sic dalin keto vlera nga pasqurat financiare qe i aneksohen ketj raporti jane ne pajtushmeri me rregullat dhe parimet kontabel ne fuqi dhe perbejne nje vleresim noemal dhe te arsyeshem . Keshtu qe ne kuadrin e vecante te opercionit te trasformimit ky vleresim i parqitet per miratim asamblese se pergjithshme .

Avantazhet e vecanta.

Nuk na u sinjalizua dhe ne vete, nuk zbulova gjate kontrolleve te kryera , asnje avantazh te vecante ne perfitim te ortakeve ose te te treteve.

Kapitalet e veta dhe kapitali themeltar.

Per tu konformuar me ligjin une vertetoj se shuma e kapitaleve te veta e cmuar ne baze te dokumentave te cilat gjejne pasqyrimin e bilancin e dt. 31.12.2002 i cili mu komunikua dhe u verifikua nga ana ime eshte me e larte se shuma e kapitalit themeltar te shoqerise ne formen juridike te sotme.

Kapitali themeltar	100.000 leke
Kapitalet e veta	2.777.683 leke

Eksporti i shendrimit
Violeta Mullai

Tirane me.....10.12.2003